



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATURA E SHTETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 47/prot,
2

Datë 05.01.2023

Lënda: Njoftim për shpalljen e vendeve vakante për pozicionet “Avokat shteti”, pranë Avokaturës së Shtetit

Në zbatim të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" i ndryshuar, rregullores për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr. 68, datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, si dhe urdhrit të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr. 60, datë 26.03.2019 "Për miratimin e rregullores për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të procesit të rekrutimit, pranimit, periudhës së provës dhe emërimit të kandidatëve për pozicionin e avokatit të shtetit gjatë regjimit ligjor kalimtar" Avokatura e Shtetit njofton se në administratën e saj janë krijuar vendet vakante si më poshtë:

I. POZICIONET VAKANTE

Në kategorinë si më poshtë:

- 3 (tre) Avokat Shteti, pranë Ministrive.

II. PËRSHKRIMI I PUNËS

II.1 Përshkrimi i punës për pozicionin “Avokat shteti” pranë ministrive:

- përfaqëson Avokaturën e Shtetit pranë gjykatave të shkallës së parë dhe atyre të apelit; njofton organin e administratës shtetërore/entin publik mbi vendimin gjyqësor, si dhe nëse vendimi ka marrë formë të prerë apo është ankimuar;
- harton dhe paraqet me shkrim para gjykatës brenda afatit dhe me cilësi, prapësimet, konkluzionet përfundimtare, pyetjet drejtuar eksperteve, kundërshtimet ndaj akteve të ekspertimit, kërkesat për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor, kërkesa për mospranim padie, ankime të veçanta, kërkesa për pezullim gjykimi apo kërkesa për marrje mase sigurimi padie, si dhe çdo akt tjetër që ka lidhje me procesin gjyqësor, për procese gjyqësore që është autorizuar të ndjekë personalisht;
- mban dhe përditëson regjistrin elektronik të çështjeve;

- informon periodikisht Kryetarin e Zyrës së Përfaqësimit Ligjor në Gjykatat Kombëtare në lidhje me veprimtarinë, në zbatim të dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi.

III. KRITERET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA

III.1 Në mbështetje të nenit 20 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" i ndryshuar, kriteret e përgjithshme për t'u emëruar Avokat Shteti janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të ketë përfunduar programin e formimit fillestar për avokat shteti pranë Shkollës së Magjistraturës;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për kryerjen e një veprë penale;
- e) të mos jetë shkarkuar nga shërbimi civil, apo çdo funksion tjetër publik, për shkelje ose paaftësi në kryerjen e detyrave;
- f) të gëzojë integritet moral dhe profesional.

III.2 Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

- a) ka përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, ose diplomë të njësuar me të, apo ka përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;
- b) ka jo më pak se 6 vite përvojë pune në sistemin gjyqësor ose në administratën publike, brenda profilit të detyrës së avokatit të shtetit;
- c) kalon me sukses testimin profesional, të organizuar nga Avokatura e Shtetit sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

Përfshihen nga parashikimi i shkronjës "c", të pikës 4, të këtij neni, kandidatët që përmbushin njërin prej kushteve të mëposhtme:

- a) kanë punuar gjyqtar ose prokuror;
- b) zotërojnë eksperiencë pune si jurist prej jo më pak se 10 vjet përvojë profesionale në administratën e Kuvendit, Presidentit, aparatit të Këshillit të Ministrave, ministri dhe institucione qendrore të pavarura, në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë;
- c) zotërojnë eksperiencë pune, si dhe integritet profesional si pedagog pranë Fakultetit të Drejtësisë apo Shkollës së Magjistraturës.

IV. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE DORËZIMI I TYRE

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dorazi ose me postë pranë protokollit të Avokaturës së Shtetit, në adresën Rr."Abdi Toptani", Nd. 5, kati IV, Tiranë, **deri në datën 13.01.2023** dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë për aplikim, sipas formatit që gjendet e publikuar në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit, në adresën <http://www.avokaturashtetit.gov.al>
2. Jetëshkrim (CV);
3. Fotokopje ID
4. Certificate familjare;
5. Diplome dhe liste notash;
6. Dëshmi penaliteti;
7. Raport mjeko-ligjor;
8. Vërtetim nga punëdhënësi që nuk ka masë disiplinore në fuqi në shërbim civil apo në funksion tjetër të administratës publike;
9. Reference nga punëdhënësi që gëzon integritet moral dhe profesional;
10. Libreze pune që dëshmon (provon) eksperiencën në punë;
11. Si dhe çdo dokument tjetër që dëshmon aftësitë profesionale (nëse disponon).

Jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e mbylljes së pranimit të dokumentacionit, bëhet verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe te veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Në rast të mosplotësimit në formën e duhur të kërkesës, apo/dhe mangësi në dokumentacionin e kërkuar, vendoset mospranimi i përkohshëm i aplikimit të kandidatit në procedurën përzgjedhëse. Mospranimi sipas kësaj pike do të jetë i përkohshëm, me kusht që të plotësohen nga kandidati brenda një afati të caktuar nga dita e njoftimit mangësitë e konstatuara. Në rast se brenda këtij afati, mangësitë ose defektet formale nuk janë plotësuar, vendoset mospranimi përfundimtar i kandidatit.

V. FAZAT E PROCESIT, PUBLIKIMI I REZULTATEVE DHE MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Procesi i përzgjedhjes përbëhet nga 4 (katër) faza të njëpasnjëshme:

- Kualifikimi;

- Provimi fillestar;
- Periudha e formimit;
- Konfirmimi në detyrë.

Në përfundim të verifikimit të dokumentacionit të depozituar, kandidatët të cilët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, renditen në një liste sipas rendit alfabetik. Lista e kandidateve të kualifikuar publikohet në faqen zyrtare të institucionit të Avokaturës së Shtetit. Kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpallje njoftohen individualisht për arsyt e skualifikimit.

Provimi fillestar zhvillohet në dy faza:

- Testim me shkrim;
- Intervistë e strukturuar me gojë.

Provimi fillestar do të bazohet në programin e miratuar me Urdhrin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr. 174, datë 15.10.2020 *"Për provimin fillestar të procesit përzgjedhës së kandidatëve për pozicionin e avokatit të shtetit gjatë regjimit kalimtar"*, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit, në rubrikën "Njoftime".

- Mënyra e komunikimit me kandidatët dhe vlerësimi i kandidaturave do të kryhet bazuar në Ligjin nr. 10018, datë 13.11.2018 *"Për Avokaturën e Shtetit"* i ndryshuar, si dhe në rregulloren *"Për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të procesit të rekrutimit, pranimit, periudhës së provës dhe emërimit të kandidatëve për pozicionin e avokatit të shtetit gjatë regjimit ligjor kalimtar"*, miratuar me urdhër nr.60, datë 26.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, e ndryshuar, e cila gjendet e publikuar në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit <http://www.avokaturashtetit.gov.al>.

Sqarim: Data, vendi dhe ora e zhvillimit të provimit fillestar do të publikohen në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit në një njoftim të dytë.

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHETITIT
ODISE MOCKA

